



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Br	1827/24
Nr. i fq. / Br. st	
Data: / Datum	27. 12. 2024
VUSHTRRI - VUÇITRN	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vuçitrn-Municipality of Vushtrri

**Procesverbali nga takimi i dytë publik me qytetarë i Kryetarit të Komunës
për punën një vjeçare Janar-Dhjetor 2024**

Dhjetor 2024

Takimi i dytë publik me qytetarë i kryetarit të Komunës

Datë: 27.12.2024

Ora: 11:00

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Takimi është hapur nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, Ferit Idrizi, i cili para qytetarëve të pranishëm ka prezantuar raportin për punën gjashtë mujore (Qershor - Dhjetor 2024) të ekzekutivit.

Të pranishëm kanë qenë edhe të gjithë drejtorët e drejtorive.

Ferit Idrizi, kryetar i Komunës së Vushtrrisë, falënderoi qytetarët pjesëmarrës në takim.

Fillimisht para juve do të paraqes një përmbledhje të punëve që janë bërë nga janari deri në muaji qershor 2024, e më pas do të keni edhe ju mundësinë që të bëni pyetje.

Totali i buxhetit që kemi pasur këtë vit ka qenë 26,770,093.00 euro.

Per investime kapitale 6,926,738 euro.

Subvencione 1,223,000.00 euro.

Komunali 571,000.00.

Mallra dhe shërbime 4,840,000.00 euro.

Për paga 13,209,301.00 euro.

Ky ka qenë buxheti për 2024, totali 26 milion 770 mijë 93 euro, i përfshirë edhe buxheti që e marrim nga qeveria dhe të hyrat vetanake

Viti 2024, ka qenë një vit shumë sfidues për faktin se kemi pasur obligimin e kontratës kolektive që ka dalë nga marrëveshja me MASHTI-t dhe Sindikatën së Arsimit – kontrata kontrate jo e oëmbushur nga ministria, ku gjykata janë lëshuar në komuna përmes përmblyesit dhe kanë marrë mjete nga të gjitha kategoritë. Në këtë rast atë që kemi mundur ta shpëtojmë ka qenë ndërmjetësimi i komunës nëpër gjykata, në mënyrë që pagat e mësimdhënësve për shujta, për licensa dhe

Vlen të theksohet se vetëm nga tetori i vitit 2023 deri tash i kemi paguar më tepër se 6 milion euro që i bie komplet buxheti i vitit për investime kapitale. Ku kjo ka rezultuar në mosrealizimin e projekteve që i kemi planifikuar në disa fshatra dhe qytet.

Disa projekte edhe pse kanë qenë të kontraktuara, na i kanë marrë mjetet megjithatë i kemi marrë edhe disa ndihma në bashkëfinancim me disa organizata e jashtme ndërkombëtare dhe disa ministri të linjës së qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në një mënyrë jemi mundur që zbrastirën financiare ta plotësojmë me mjetet që i kemi marrë, megjithatë punët dhe aktivitetet në terren nuk i kemi ndalë në asnjë moment dhe ka shumë projekte që janë duke u realizuar në qytet dhe në fshatra.

Le të fillojmë me arsimin, të cilit prej marrjes së mandatit i kam dhënë prioritet

Me qëllim të ngritje së cilësisë, me qëllim të ngritjes së kapacitetit të të rinjëve ne i kemi subvencionuar të rinjtë në forma të ndryshme kku i kemi ndarë në disa kategori

subvencioni ne kategori arsimit per te rritur- zanate, ku të gjithë të rinjtë që kanë qenë të interesuar e kemi subvencionuar trajnimin e tyre 100% në qendrën Diakonie, shumica e keëtyrë të rinjëve që kanë kryer trajnime në periudha 6 deri ne 8 muaj, ose kanë hapur bizneset e tyre - startup- dhe shumica kanë filluar punën nëpër kompani të ndryshme siç është rasti tek të rinjtë që kanë mbaruar kursin për elektrikist janë punësuar në ndërmarrjen “Përparimi” dhe sot ata kujdesen për mirëmbajtje e ndriçimit publik në Vushtrri.

Po ashtu kemi investuar shumë për të rinjtë Nen moshën 25 vjecare, pra për ndritjen e kapaciteteve në shkathtësi të buta, ku kemi pasur një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me të gjitha kompanitë dhe organizatat që ofrojnë kurse në gjuhën gjermane, angleze, frënge, teknologji të informimit dhe komunikim.

Vetëm në vitin 2024 i kemi paguar 144,000.00 euro, një numër shumë i madh i këtyre të rinjëve dhe të rejave janë të punësuar në kompaninë Speex.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të të rinjëve që studiojnë jashtë vendit, komuna e Vushtrrisë është komuna e vetme e cila ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me “York University” që është një kampus i universitetit nga Britania e Madhe në Selanik, ku kemi ofruar bursa në 3 drejtime, në teknologji të informimit, programim, Inteligjence Artificiale (AI) si dhe psikologji klinike.

Gjithashtu edhe vitin e ardhshëm do ta vazhdojmë bashkëpunimin me ta, si dhe do ta promovojmë më shumë, në mënyrë që të rinjtë dhe të rejtat ta kenë mundësinë të shkojnë të studiojnë në këto universitete.

Edhe në vitin e ardhshëm pritet bashkëpunim dhe promovim më i madh

Kemi ndarë bursa studimi për të gjithë studentët vushtrrias, që studiojnë në Ballkanin perëndimor ku vlera e bursës së studimit ka qenë 800 euro për student, ndërkaq për studentët që studiojnë në universitetet publike dhe private në Kosovë, kemi ndarë 87 bursa, me nga 600 euro, ku kjo bursë e ndarë nga Komuna jonë ka qenë 100 euro më e lartë se në Universitetin e Prishtinës.

Te shërbimet publike, kemi filuar me investimi i tregut të gjelbër me parkingun nëntokësor që kap vlerën 1,131,056.00 euro, projekt ky, bashkëfinancim mes Komunës së Vushtrrisë dhe organizatës IRK (Islamic Relief Kosova), projekti është planifikuar të përfundoj deri në vitin e ardhshëm. Deri më tani janë kryer punimet e vrazhda, parkingu nëntokësor si dhe është kryer punimi i vrazhdë i zyrave të parkingut. Gjithashtu mendojmë se mirëmbajtjen e këtij parkingu do ta bëjë ndërmarrja “Përparimi”

Kemi filluar restaurimin e sheshit “Adem Jashari, duke ndërtuar parkingun nëntokësor, dy amfiteatro verore dhe disa dyqane përreth. Ka qenë një projekt shumë sfidues, pasi që ka përfshirë shumë infrastrukturë nëntokësore, duke përfshirë linjën kryesore të rrjetit të ujësllësit fi 400, e cila e furnizon qytetin me ujë, tensionin e lartë të energjisë elektrike, fijen optike të

postës dhe një rrjet të dendur të kanalizimeve. Të gjitha këto punë janë realizuar me shumë sukses. Kjo pjesë vetëm se ka filluar të marrë pamjen finale; janë duke u ndërtuar dyqanet në pjesën e poshtme, ndërkaq janë kontraktuar edhe kubëzat dhe pllakat e granitit, të cilat shpejtë edhe do fillojnë të vendosen.

Projekt tjetër është realizimi i projektit “Ura e Gurit”, me vlerë prej 357,917.22 euro, e që është bashkëfinancim me MZHR, aty janë duke u ndërtuar dy fusha të tenisit dhe një tjetër fushë multifunksionale. Kemi vlerësuar se ky projekt është mëse i nevojshëm në atë pjesë të qytetit, dukë marrë parasysh që ajo pjesë ka filluar të popullohet dhe kanë filluar ndërtimet e larta.

Kemi rehabilituar rrugën “Dëshmorët e Kombit” me vlerë prej 643,459.00 euro.

Kemi filluar edhe rehabilitimin e rrugës “2 Maji” që është projekt 3 vjeçar, i cili përfshin edhe rregullimin e shtratit të lumit së bashku me infrastrukturë.

Kemi rregulluar edhe rrugën Pestovë-Druar, në vlerë prej 344 394,62 që është një ndër arteriet më të rëndësishme, të qarkullimit të mallrave dhe banorëve të Artakollit, Qyqavicës dhe Drenicës.

Projektet tjera që kemi vazhduar është edhe ri-asfaltimi i rrugës “Avni Saraçi”, gjithashtu edhe e kemi zgjeruar; kemi ndërtuar trotuarin, shtegun për bicikleta dhe kemi mbetur t’i vendosim edhe trupat ndriçues.

Zgjerimi dhe riasfaltimi i rrugës Drenica, edhe kjo arterie shumë e rëndësishme, por që ka qenë shumë e ngushtë. Rrugës ja kemi bashkangjitur trotuarin, shtegun për bicikleta dhe ndriçimin.

Rregullimi i rrugës “Lumni Surdulli”, rrugë e cila lidh varrezat e qytetit me fshatin Nadakoc, rrugë kjo e cila gjithashtu është duke u ndërtuar sipas standardeve, së bashku me infrastrukturën nëntokësore, përpos kanalizimeve atmosferike dhe fekale, do të futen në tokë edhe kabllot e telefonit dhe të rrymës. Gjithashtu vlen të ceket se kemi hasur në shumë uzurpime të toave publike, por dua t’i falenderoj të gjithë ata qytetarë, që në mënyrë vullnetare kanë larguar muret e oborreve dhe na e kanë mundur zgjerimin e rrugës.

Është duke u rregulluar edhe rruga “Bekim Berisha-Abeja” në Begaj, ku kemi vendosur infrastrukturën nëntokësore, e gjithashtu në pranverë presim që qytetarët e asaj ane, t’i lëshojnë pronat e uzurpuara sipas marrëveshjes e gjithashtu edhe një pjesë të pronave të veta, për të na e mundur kryerjen e këtij projekti, gjë që i falenderoj shumë pasi që kemi hasur në shumë mirëkuptim nga ana e tyre. Vërtetë ka qenë një projekt shumë sfidues, por kam qenë i vetëdijshëm për sfidat që na kanë pritur, por që ka qenë shumë e domosdoshme rregullimi i kësaj rruge, pasi që edhe kjo rrugë shërben lidhje e rrugëve të tjera të qytetit e poashtu edhe lidhjen me autostradë.

Kemi filluar rehabilitimin dhe riasflatimin e rrugës në tri Dumnicat, me vlere prej 1,296,417.00 euro, projekt ky i cili pritet të realizohet në vitin e ardhshëm sepse është projekt 2 vjeçar.

Rehabilitii i rrugës Akrahticë – Balinc, me vlerë prej 937,986 euro. Edhe ky projekt pritet të përfundoj në vitin e ardhshëm.

Projekti për Dumnicat si dhe projekti i rrugës Akrahticë – Balinc, janë bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës.

Rehabilitimi i rrugës nga ura e lumit Silnica deri te Llamkos 639,661.00 euro, edhe kjo rrugë do të bëhet sipas standardeve të larta, e po ashtu edhe ky projekt është bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës.

Në fushën e bujqësisë, jemi komunë që kemi investuar në disa drejtime, ku kemi subvencionuar 50 %, ujitjen e tokave, të cilat ndodhen në sistemin e ujitjes.

Kemi subvencionuar 103 fermerë me 0,5 cent për litër të qumështit, ndoshta jemi komuna e vetme që kemi filluar subvencionimin e qumështit, me qëllim të nxitjes së fermerëve që të rritet numri i bagëtive.

Po ashtu kemi subvencionuar edhe fermerët e deleve dhe dhive për 5 euro për kre, ndërkaq duke pasur parasysh se janë specie në zhdukje, fermerët për buallica, i kemi subvencionuar me 100 euro për krer.

Edhe bletarët i kemi subvencionuar me 5 euro për shoqëri bletësh.

Sa i përket Drejtorisë së Rinisë, Kulturës dhe Sportit; Komuna nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm, për t'i mbuluar të gjitha aktivitetet sportive të klubeve dhe organizatave të ndryshme rinore, ku gjithsejt i kemi pasur 49,000.00 euro, por, e kemi shfrytëzuar ligjinin për subvencionim të sporteve dhe kemi ndërmjetësuar tek shumë kompani të fuqishme për të ndihmuar klubin e futbollit, klubet e hendbollit në Vushtrri dhe në Samadrexhë. Tani jemi në diskutime e sipër edhe me disa kompani të tjera, ku presim që të na ndihmojnë, në mënyrë që të rinjtë dhe të rejat t'i kenë disa kushte më të mira.

Në fushën e mbrojtjes dhe shpëtimit, kemi punuar gjatë gjithë vitit në pastrimin dhe zgjerimin e lumenjëve, përrockave dhe përrenjëve.

Kemi pastruar, zgjeruar dhe murosuar shtratin e lumit në Smrekonicë.

Kemi bërë pastrimin dhe zgjerimin e lumit Silnica dhe Tërstena

Pastrimi zgjerimi dhe murosja e lumit Podranqa.

Për evitimin e vërshimeve, kujdes të veçantë i kemi kushtuar lumit Silnica, që e kemi pastruar deri në fund të fshatit Pestovë. Është hera e parë që ky lum po pastrohet thellësisht.

Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale kemi renovuar QKMF-në dhe e kemi zhvendosur nga zona e tregut të bagëtive, te shkolla "Naim Frashëri", për të vetmen arsye për shkak se hyrje-daljet janë më të lehta.

Në bashkëfinancim me Islamic Relief Kosova, kemi blerë mamografinë, e cila në fillim të vitit të ardhshëm do të bëhet funksionale.

Më pas fjala ka kaluar tek qytetarët, të cilët kanë paraqitur kërkesat e tyre.

Gëzim Haziri nga fshati Druar, shtron pyetje rreth rrugës ku i kanë shtëpitë, një rrugë me gjatësi 150m-200m. Lagja “21 Martirët”. “Nuk ka ardhë askush ta vizitojë që ta shoh nëse është e kalueshme ose jo; Kam bërë shumë kërkesa por nuk është marrë parasysh asgjë”.

Kërkesë e tij ishte që kryetari të dal ta shoh gjendjen e rrugës e cila është e pakalueshme.

Ahmet Seferi nga fshati Shalë, paraqet shqetësimin e tij për migrimin nga fshati në qytet të të rinjëve. Paraqet shqetësimin e tij se në Shalë, mungesa e ujit dhe kanalizimit janë pengesë.

Bajram Uka banor i rrugës “31 Maji”- lagje e krijuar pas lufte. Këtë lagje e kanë lidhur dy rrugë, njëra rrugë që vjen nga stacioni i pompave të Ibër Lepencit dhe tjetra nga lagja “Gërxfhalu” në drejtim të njësisë së zjarrëfikësve. Ka kohë që këto dy rrugë janë dëmtuar rëndë nga kompania që ndërton autostradën dhe janë bërë të pakalueshme. A do të ketë ndonjë riparim ose rregullim të këtyre dy rrugëve në vitin e ardhshëm.

Ramadan Rashani, përfaqësues i Shoqatës së Peshkatarëve- a ka diçka që ke premtu e ende nuk e ke fillu apo do ta fillosh.

Sabrije Hasani nga Dumnica e Poshtme- nuk ka pas asnjëherë vizita, fëmijët nuk po mundën të shkojnë në shkollë për shkak të rrugës së pakalueshme.


Trim Klinaku nga fshati Bivolak - Objekti i familjeve të dëshmorëve nuk është nisur ende, andaj a do të bëhet diçka për të. Premtimi është bërë nga ish kryetari Bajram Mulaku

Smajl Haziri, banor nga Vushtrria - 200 nënshkrime janë mbledhur; pse nuk po kalon punimi i analizave në objektin e vet ku është paraparë në rrugën “Dëshmorët e Kombit”.

Takimi ka përfunduar në ora 12:30.

Procesmbajtëse:

Albiona Isa




Kryetari i Komunës së Vushtrrisë

Ferit Idrizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Takimi i dytë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 27.12.2024

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
1	Labrije	Hasani	Dumnic
2	Norçe Memn	Memn	Vushtrri
3	Remzi E vereti	Remzi	Morhoci
4	EXIVE	Seferi	Seferi
5	Almet	Seferi	Seferi
6	KUSHTRIK KLINAKU	Mali	VUSHTRRI
7	Blinera Mehmeti	Blinera	Mitrovicë
8	Beut Maxhumi	Beut	Vushtrri
9	SHKELZEN OSMANI	Shkelzen	VUSHTRRI
10	Msimail Hoxhi	Msimail	Vushtrri
11	SAKLIP KRAJHORI	Saklip	Vushtrri
12	Murtoza Dalleri	Murtoza	Vushtrri
13	Gëziri Haxhi	Gëziri	Vushtrri
14	RAMADAN KASHANI	Ramadan	Vushtrri
15	ARBEN PARDUZI	Arben	Vushtrri



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn-Municipality of Vushtrri



Lista e pjesëmarrësve

Takimi i dytë publik me qytetarë

Vendi: Qendra e Kulturës "Hasan Prishtina"

Datë: 27.12.2024

Ora: 11:00

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Nënshkrimi	Vendbanimi
16	Bajram Uka	Bajram Uka	Rr. 31 MAJ I STUDIME
17	Hamit Makçi	Hamit Makçi	Fidgim Pashin Makçi, Rr. 29/1
18	Imrije Begiri	Imrije Begiri	Adem Isahaj Vushtri
19	RAIF LAHU	RAIF LAHU	"LOJTI" MUSIQI VUSHTRRI
20	ERGIN SUNAVI	ERGIN SUNAVI	VUSHTRRI
21	Benjamin Doli	Benjamin Doli	Abroshke.
22	IZET MIFER	IZET MIFER	VUSHTRRI
23	Hyrrie Uka Horke	H. Uka	Vushtrri
24	DRILON JUSUF	DRILON JUSUF	VUSHTRRI
25	DESIM DZMINI	DESIM DZMINI	VUSHTRRI
26	Musgj Terbuja	Musgj Terbuja	Vushtrri
27	Medina Benjaku	Medina Benjaku	Vushtrri
28	Thalide	Thalide	Vushtrri
29	ARTIM SHITI	ARTIM SHITI	Oshlan
30			